IMMIGRANT VISAS

Instructions for Immigrant Visa Applicants

Reminder: Civil documents issued more than one year ago are considered expired. If your civil documents were issued over a year ago, bring updated original copies of civil documents and/or financial evidence such as tax returns which may have changed or been superseded since you originally submitted them to the NVC or Consular Section for review. Bring a new photo of size 5 x 5 cm and the DHL registration page on your interview date.

Required Documents For Each Immigrant Visa Applicant:

1. PHOTOCOPY OF PASSPORT: A photocopy of all applicants' passports must be provided. The beneficiary's passport must be valid for travel to the United States and must have at least one year validity beyond the issuance date of the visa. You must present your passport at the interview date. Passport must bear your most recent name.

2. FORMS: Form DS-260, Application for Immigrant Visa and Alien Registration, must be fully completed. Please do not leave any questions blank on the application forms. Questions that do not apply to the applicant's particular situation should be answered "Does Not Apply". This form can be downloaded through the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Visa Application Forms." If you lost your Invoice I.D. number, you may contact NVC to recover it. You may read here the FAQs on how to fill out form DS-260.

3. BIRTH CERTIFICATES: Original birth certificate for each applicant. It should read Certificate of Birth, not Personal Certificate (e.g., the certificate translated in six languages reads "Certificate of Birth – Certifikatë Lindjeje). Birth certificates must be issued by the government of the country where the applicant was born. Albanian birth certificates for applicants **not** born in Albania will not be accepted. Birth certificate must have all names used.

4. MARRIAGE CERTIFICATE: Original marriage certificate for each applicant.

5. DIVORCE DECREE OR DEATH CERTIFICATE: If previously married, please include proof of termination of that marriage whether by death or divorce (e.g., death certificate of previous spouse, translated final decree of divorce, etc).

6. MINISTRY OF JUSTICE CERTIFICATE: Criminal record (in Albanian Dëshmi Penaliteti) issued by the Albanian Ministry of Justice for each applicant age 16 years or over in current and any former names, **including maiden names**. Note: Applicants are often refused for not submitting the certificate in **all names/surnames** used.

Important: When applying for the Ministry of Justice certificate at the Post Office, applicants must clearly note on the court certificate application that they are applying for a U.S. visa. The Ministry of Justice certificates for applicants for U.S. visas will be transferred directly to the Consular Section of the U.S. Embassy in Tirana. Only criminal certificates obtained directly through U.S. Embassy Tirana are acceptable; applicants may not present their own certificates. In order to certify that you've applied for the MOJ certificate, please submit a copy of the receipt of payment for the criminal record, which you received from the Albanian Post Office (keep the original one with you, for any rare case where the issuing office in error sends the certificate back to the Post Office where you applied.)

You should send NVC a copy of the receipt of payment along with a statement in English as evidence that you have applied for the MOJ certificate. Once you have applied, you do not need to submit this document to NVC, as it will be stored at the U.S. Consular Section in Tirana.

NOTE: Persons convicted of a crime must obtain court records, even if the beneficiary has been pardoned or granted amnesty, or the criminal conviction is expunged. These documents must be accurately translated and notarized.

8. POLICE CERTIFICATES FROM A FOREIGN COUNTRY: A translated and notarized Police Certificate from a foreign country for applicants age 16 or over, from his or her country of current residence, if residence in such country exceeds six months, or from countries of previous residence, if residence there was for more than one year. The certificate must be in current and any former names, **including maiden names**. Note: applicants often get refused 221(g), because of not submitting the certificate in all names they've used. For further information, please read the Police Certificates title of the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Documents the Applicant Must Submit to the NVC."

Applicants who are or were residents in Greece should apply for the Greek Police certificate at the Greek Embassy in Tirana, which will transfer the certificate directly to the U.S. Embassy. Applicants may not present their own Greek police records. These records do not require translation.

Documents issued by Greek authorities (such as court records, birth certificates, etc.) must be apostilled and translated into English by the Translation Services of the Greek Ministry of Foreign Affairs. Please visit the Greek Ministry of Foreign Affairs website for more information and contact information.

9. MILITARY RECORDS: issued by the Army Recruiting Office (Zyra e Rekrutim-Mobilizimit in Tirana), for all **male** applicants age 18 and over, regardless of having served the military service or not, and all female applicants with prior military service.

10. OTHER CIVIL DOCUMENTS: Decisions issued by the responsible state authority regarding **name changes**, age amendments, adoption and similar subjects must also be submitted at the time of interview.

11. DOCUMENT EXPIRATION: All documents should bear issuance date less than one year ago from interview date. Otherwise, your case will be refused until we receive updated documents.

12. TRANSLATION: Certified English translations must accompany all documents not in Albanian language, or in English, except for court decisions which are required to be translated. Translations must be certified by a competent translator and sworn before a Notary Public.

13. PHOTOS: Regardless of age, all U.S. Immigrant Visa applicants must present two un-retouched color photographs, approximately 5 X 5 cm in size, taken on a white background. The photo should have a full frontal view of the face, with the head centered in the frame. For more details please visit the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Photograph Requirements." If the requirements are not met, the photo will not be accepted. **Bring new photo on the interview date,** taken within the **last six months.** Applicants are often refused 221(g) due to expired photos, or photos not meeting standards.

14. DHL COURIER CONFIRMATION PAGE. Each visa applicant, regardless of age, must create an account at http://albania.usvisa-info.com, and follow the instructions on how to register for DHL courier service to return your passport upon completion of your case, and/or document submission if requested by the Consular Officer. Optionally you may contact the Call Center at the toll free numbers (+355) (0)44-500-037 (in Albania), (703)-439-2349 (in the United States), or USVisaAlbania (on Skype) to speak to an agent who will assist you. Please save your account details as you may need to go back to this website to learn about your passport delivery status, and/or to submit new documents to the Consular Section, if instructed to do so. This free of charge DHL courier service is valid only within Albania.

- Print out the DHL confirmation page and bring it on the appointment date. If you do not register, it will create delays in processing of your case. **A visa cannot be issued without a DHL registration.**

15. EVIDENCE OF RELATIONSHIP with your U.S. citizen spouse (for CR-1, F2A, and IR-1 petitions). Evidence of relationship to petitioner, such as photographs, correspondence, or other evidence of relationship over time. Evidence that the petitioner visited Albania, such as ticket stubs or travel reservations.

16. PETITIONERS of visa category IR5 (U.S. citizens petitioning for their parents) may join their parent/s on the interview date. Petitioners of other visa categories are not allowed.

17. EVIDENCE OF FINANCIAL SUPPORT:

For Petitioner:

a) Birth certificate of petitioner, which should be dated less than one year from the interview date.
b) Original Affidavit of Support, Form I-864 (not photocopy, nor sent by email), for each petition filed.
c) A photocopy of the sponsor's U.S. passport, naturalization certificate, or legal permanent resident card. Regardless of whether you (the petitioner) do or do not qualify to file, you must file form I-864.
d) A recently issued job letter that includes information on length of employment and salary.
e) Tax returns for most recent year (Form 1040), or an Internal Revenue Service (IRS) transcript (even if the sponsor filed electronically). To request IRS-generated transcripts or copies of a tax return, please visit the IRS website. This document must be less than 12 months old when presented on the interview date.
f) Most recent tax year W-2s for all jobs held.
g) If you are married, your spouse must also complete and submit an original Form I-864**A**, (note: this form is different from Form I-864), accompanied by a photocopy of his or her U.S. passport, naturalization certificate, or legal permanent resident card. You can find Form I-864 and I-864A at the U.S. Citizenship and Immigration Services (USCIS) website. For more information for preparing Affidavit of Support forms, please visit the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Affidavit of Support Instructions."
h) If you did not file taxes in the last year, you **must also prepare a signed statement explaining why you were not required to file.**

Joint Sponsor:

i) If your (petitioner's) income does not meet the requirements of 125 percent of the Poverty Guidelines, established yearly by the U.S. Department of Health and Human Services (DHHS) or, if you are not qualified to sponsor your relative financially, you must find a joint sponsor who can present a signed Form I-864, accompanied by a photocopy of the sponsor's U.S. passport, naturalization certificate, or legal permanent resident card, tax returns of the last year(Form 1040), or an Internal Revenue Service (IRS) transcript, most recent tax year W-2s for all jobs held, and a recently issued job letter**, in addition to your I-864 Affidavit of Support**. Regardless of whether you (the petitioner) do or do not qualify to file, you must file form I-864.
j) If the joint sponsor is married, his or her spouse should also complete and submit an original Form I-864A, accompanied by a photocopy of his or her U.S. passport or legal permanent resident card. For more information on the joint sponsor's required documentation please visit the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Checklists for Preparing Affidavit of Support Forms."

Processing of Immigrant Visas

Upon receipt, each application will be reviewed by NVC. If the documentation is complete, NVC will schedule an appointment and notify the petitioner and the beneficiary with an appointment letter. NVC will send to the petitioner, beneficiary, and/or agent of choice the appointment letter by e-mail, regular mail, or express courier.

Before The Interview

1. THE VISA APPLICANTS of these categories CR1, IR1, and F2A, should read The Information on the Legal Rights Available to Immigrant Victims of Domestic Violence in the United States and Facts about Immigrating on a Marriage-Based Visa. Failure to read this information may delay processing of your visa.

2. MEDICAL EXAMINATION: Before their final immigrant visa interview, all applicants are required to undergo a medical examination performed only by the medical doctors authorized by this Embassy to administer the examination.

The beneficiary should go for the medical examination **exactly three weeks prior** to his/her interview date, unless you received your appointment package notification later than three weeks ahead of time. In cases where you do not receive your appointment package until less than three weeks prior to your interview, you

should contact the eligible physicians during business hours to schedule an appointment as soon as possible, or appear at one of the panel physician offices along with the required documentation.

You will have to print the medical examination, read it carefully, fill it in, and present it to one of the panel physicians. The beneficiary is also responsible for the cost of the examination. A medical examination is also required for each accompanying child. You should have with you the appointment letter on the day of medical examination.

Do not send the results of your medical examination to this office before your interview. You will be required to submit your medical report to this office at the time of your interview. **Do not bring X-ray CD to the Embassy.** Please read section "After you have Received the Passport and the Visa Packet" below regarding the X-rays. You can download the Medical Examination form by visiting the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Interview Preparation - Medical Examination." Search for TIA –Tirana and then download the medical examination form.

What Do You Need to Bring to the Interview:

- The interview appointment letter you received from the NVC (or in a few cases from the Consular Section);
- Medical examination, unopened;
- New photo, taken in the last 6 months;
- Civil documents issued more than one year ago are considered expired. If your civil documents were issued over a year ago, bring updated original civil documents and/or financial evidence such as tax returns which may have changed or been superseded since you originally submitted them to the NVC for review.
- If a sponsor filed an I-864 (Affidavit of Support) AND provided the NVC with proof of an IRS Federal Income Tax Extension in lieu of a Federal Income Tax Return, the applicant must bring the sponsor's most recent Federal Income Tax Return to the visa interview.
- DHL confirmation page.

Interview

APPLICATION FEE: Please visit the U.S. Department of State's Bureau of Consular Affairs web page "Fees for Visa Services" for detailed information about immigrant visa fees. If the petitioner has already paid this fee with NVC for you, then you do not need to pay again. If not, you will be required to pay the application fee at the time of your interview. The payment may be made in cash only to the consular cashier, in U.S. Dollars or Albanian Lekë.

The interview date is scheduled by NVC, and you, the petitioner, or the agent of choice will receive the notification regarding the appointment date by the NVC. Only in a few cases the appointment date is scheduled by the Consular Section of the U.S. Embassy Tirana.

You can view the status of your visa case at: https://ceac.state.gov/CEAC/. All you need is your case number and the location of your interview to monitor your case's progress.

After the Interview

After your personal interview with the Consular Officer, if your file is complete and you are found qualified, your visa will be issued and sent together with the visa packet by DHL courier service to the DHL branch you selected when registering for DHL service in Albania. You will be notified by DHL via e-mail to pick up your passport. Important: Please do not open the visa packet envelope.

Some visa applications may require: a) additional documents, or b) further administrative processing.

a) When additional documents are requested, the Consular Officer will provide you with a refusal letter, which lists the missing documents. Only the marked items apply in your case. Please note that the Consular Officer may use the Albanian language to explain the documents required by the applicant, and English language to explain the documents required by the petitioner or the sponsor. Therefore, you may have to send a copy of the refusal letter by fax or email to the petitioner. It is strongly

recommended that you send all the requested documents at once; otherwise, your case may take more time.

b) A further administrative processing takes additional time after the visa applicant's interview by a Consular Officer. Applicants are advised of this requirement when they apply. Most administrative processing is resolved within 60 days of the visa interview. When administrative processing is required, the timing will vary based on individual circumstances of each case. Before making inquiries about the status of administrative processing, applicants or their representatives will need to wait at least 60 days from the date of interview or submission of supplemental documents, whichever is later.

Most Important

No assurance can be given in advance that a visa will be issued. A consular officer can make a decision only after the formal application and all documents are reviewed, and that officer has personally interviewed the applicants.

Beneficiaries should not make any travel arrangements for departure, dispose of personal property or make other life changes until the visa has been issued. An immigrant visa is valid for a maximum of six months from the date of issuance. Applicants must travel and apply for admission to the United States before their immigrant visas expire.

This office will make every effort to expedite the process. However should complications arise, applicants may be required to return to this office or furnish additional information.

Section 203(g) of the U.S. Immigration and Nationality Act requires that an intending immigrant pursue his/her visa application within **one** year from the date he/she is informed that it is possible to do so. If you fail to do so within one year from the date of the attached letter, your application and any visa petition approved for you will be cancelled.

Kujtesë: Dokumentet civile të lëshuara më parë se një vit konsiderohen të skaduara. Nëse dokumentet janë lëshuar më shumë se një vit më parë, sillni dokumente civile të lëshuara kohët e fundit dhe/ose prova financiare si p.sh.: deklarimin e taksave të cilat mund të kenë ndryshuar që nga koha kur ju i keni dërguar ato fillimisht në NVC ose Seksionin Konsullor për shqyrtim. Sillni fotografi të re me përmasa 5 x 5 cm në ditën e intervistës dhe fletën e regjistrimit të DHL-së.

Dokumentacioni i Kërkuar nga secili Aplikant i Vizës Emigruese

1. FOTOKOPJA E PASAPORTËS: Një fotokopje e faqes me të dhënat biometrike, pavarësisht moshës. Pasaporta e aplikantit duhet të jetë e vlefshme për udhëtim dhe duhet të ketë të paktën një vit vlefshmëri përtej datës së lëshimit të vizës. Ju duhet të paraqisni pasaportën tuaj në datën e intervistës. Pasaporta duhet të përmbajë emrin e mbiemrin tuaj të përditësuar (p.sh.: për rastet e personave të sapomartuar).

2. FORMULARI Elektronik i Vizës Emigruese: Formulari DS-260. Formulari DS-260 duhet plotësur në të gjitha pikat në Anglisht. Mos lini asnjë pyetje pa plotësuar. Pyetjeve që nuk aplikohen për rastin e aplikantit duhet t'i përgjigjeni me "Does Not Apply". Ky formular gjendet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit, Byrosë së Çështjeve Konsullore "Formularë të Aplikimit për Viza". Nëse juve ju ka

humbur Numri Juaj i Faturës I.D. (Invoice I.D. number), ju mund të kontaktoni NVC-në për ta rimarrë atë. Lexoni Pyetje të Shtruara Shpesh (në Anglisht) mbi plotësimin e formularit DS-260.

3. CERTIFIKATA E LINDJES: 1 (një) certifikatë lindjeje për secilin aplikant. Certifikata duhet të lexojë Certifikatë Lindjeje, jo certifikatë personale (p.sh.: certifikata me 6 gjuhë lexon Certifikatë Lindjeje). Certifikata e lindjes duhet të jetë lëshuar nga shteti ku ka lindur aplikanti. Certifikata duhet të përmbajë të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur.

4. CERTIFIKATA E MARTESËS: 1 (një) certifikatë martese për secilin aplikant (nëse jeni i/e martuar).

5. VENDIM I GJYKATËS PËR DIVORCIN APO CERTIFIKATË VDEKJEJE: Nëse keni qenë të martuar më parë, përfshini prova të përfundimit të të gjitha martesave të mëparshme, qoftë për shkak të vdekjes apo të divorcit (si p.sh. certifikatë vdekje të bashkëshortit/es, vendimi përfundimtar i divorcit i përkthyer, etj).

5. VËRTETIM I GJENDJES GJYQËSORE NGA MINISTRIA E DREJTËSISË: 1 (një) vërtetim nga Ministria e Drejtësisë (dëshmi penaliteti) për të gjithë aplikantët mbi moshën 16 vjeç. Në rastet kur keni përdorur me shumë se një emër apo mbiemër, vërtetimi duhet t'i përfshijë të gjithë emrat dhe/apo mbiemrat e përdorur, **përfshirë mbiemrin e vajzërisë**. Kujdes: Shpesh aplikantët refuzohen 221(g) vetëm se ata nuk kanë përfshirë të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur në vërtetim.

E rëndësishme: Kur të aplikoni pranë Zyrës së Postës, duhet të shënoni "Ambasada Amerikane" si përgjigje e pikës "Institucioni për të cilin kërkohet certifikata" tek formulari i aplikimit për vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Vërtetimet e gjendjes gjyqësore të aplikantëve për Vizë Amerikane do të dërgohen direkt në Zyrën Konsullore të Ambasadës Amerikane. Vetëm vërtetimet e marra direkt nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore do të pranohen; aplikanti nuk mund të paraqesë vetë vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Për të dëshmuar që ju keni aplikuar për dëshminë e penalitetit, duhet të na dërgoni një kopje të mandatit të arkëtimit nga Posta Shqiptare (origjinalin mbajeni për rastet e rralla kur Zyra e Gjendjes Gjyqësore gabimisht jua ka kthyer vërtetimin pranë zyrës postare ku ju aplikuat).

Ju duhet t'i dërgoni NVC-së një kopje të mandat-pagesës dhe një shpjegim në anglisht për të treguar që ju keni aplikuar për dëshminë e penalitetit. Pasi të keni aplikuar, juve nuk ju duhet ta dorëzoni këtë dokument pranë NVC-së, pasi ajo do të depozitohet në Seksionin Konsullor të SHBA-së, Tiranë.

SHËNIM: Personat që janë dënuar për një vepër penale duhet të paraqesin vendimin e gjykatës të përkthyer e noterizuar, ku të tregohet dënimi, pavarësisht faktit nëse personi është falur, ka fituar amnistinë, apo është rehabilituar.

8. VËRTETIM NGA POLICIA E NJË VENDI TË HUAJ: 1 (një) vërtetim nga Policia e një vendi të huaj për personat mbi moshën 16 vjeç, **të përkthyer dhe noterizuar në Anglisht**, në rastet kur jetoni aktualisht mbi se 6 muaj në atë vend, ose në rastet kur keni jetuar më parë më shumë se një vit. Në rastet kur keni përdorur më shumë se një emër apo mbiemër vërtetimi duhet t'i përfshijë të gjithë emrat dhe/apo mbiemrat e përdorur, **përfshirë mbiemrin e vajzërisë**. Kujdes: Shpesh aplikantët refuzohen 221(g) vetëm se ata nuk kanë përfshirë në vërtetim **të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur**, gjë që ju kushton kohë dhe kosto. Për më tepër informacion, vizitoni faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "Dokumentacioni që Aplikanti Duhet të Dërgojë në NVC".

Personat që kanë jetuar në Greqi duhet të aplikojnë pranë Ambasadës Greke në Tiranë për vërtetimin e policisë greke. Ambasada Greke do ta dërgojë vërtetimin direkt në Seksionin Konsullor të Ambasadës Amerikane në Tiranë. Vërtetimet e sjella nga vetë aplikantët nuk pranohen. Vërtetimet e sjella nga vetë aplikantët nuk pranohen. Ky dokument nuk ka nevojë të përkthehet.

Dokumentet e lëshuara nga autoritetet greke (si p.sh.: vendime gjyqësore, certifikatë lindje, etj.) duhet të kenë vulën apostille dhe të jenë të përkthyera në Anglisht nga Zyra e Përkthimeve e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë. Për më shumë informacion dhe numër kontakti, vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë (në Anglisht).

9. VËRTETIM USHTARAK: 1 (një) vërtetim nga Zyra e Mobilizim-Rekrutimit të Ushtrisë për të gjithë aplikantët **meshkuj** mbi moshën 18 vjeç, pavarësisht nëse e kanë kryer shërbimin ushtarak ose jo; si dhe për aplikantet femra që kanë kryer shërbim të mëparshëm ushtarak.

10. DOKUMENTE TË TJERA CIVILE: Vendime të lëshuara nga autoriteti shtetëror përgjegjës në lidhje me **ndryshimin e emrit/mbiemrit, moshës**, birësimit, apo rasteve të ngjashme, duhen dorëzuar ditën e intervistës.

11. SKADIMI I DOKUMENTEVE: Të gjitha dokumentet duhet të jenë marrë nga zyrat përkatëse jo më parë se një vit nga data e intervistës. Përndryshe, rasti juaj do të refuzohet derisa ju të sillni dokumentet e përditësuara.

12. PËRKTHIMI: **Nuk ka nevojë për përkthim e noterizim** të dokumenteve në gjuhën shqipe të lëshuara nga autoritetet shqiptare. Vetëm dokumentet që nuk janë në gjuhën Shqipe ose Angleze duhet të përkthehen në Anglisht dhe të noterizohen. Përjashtim bëjnë vendimet gjyqësore (si p.sh. të divorcit apo ato që tregojnë një dënim), të cilat duhen përkthyer e noterizuar.

13. FOTOGRAFIA: Pavarësisht nga mosha, të gjithë aplikantët e vizave emigruese për në SHBA, duhet të paraqesin **dy** fotografi me ngjyra, të papërpunuara me programe kompjuterike, me përmasa 5 cm x 5 cm, me sfond të bardhë. Fotografia duhet të ketë një pamje frontale, me kokën në qendër të fotografisë. Për më shumë detaje, vizitoni faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "Kërkesat e Fotografisë". Në qoftë se kërkesat nuk plotësohen, fotografia nuk do të pranohet. Fotografia duhet të jetë bërë brenda **gjashtë muajve të fundit**. **Sillni dy fotografi të reja ditën e intervistës, të cilat të jenë nxjerrë brenda 6 muajve të fundit.** Kujdes: Shpesh aplikantët refuzohen 221(g) vetëm se ata nuk kanë sjellë fotografi të re ditën e intervistës, ose sepsenuk përmbushin standartet.

14. FLETA E KONFIRMIMIT TË REGJISTRIMIT NË SHËRBIMIN POSTAR DHL: Pasi të keni marrë njoftimin nga NVC-ja për datën e takimit për intervistë, secili aplikant i vizës, pavarësisht moshës duhet të krijojë një llogari në http://albania.usvisa-info.com, dhe të ndjekë udhëzimet në atë faqe interneti për t'u regjistruar për shërbimin postar DHL nën vizat emigruese. Gjithashtu, ju mund të kontaktoni Qendrën e Telefonatave në numrat pa pagesë (+355) (0) 445-000-37 (nga Shqipëria), (703) 439-2349 (nga Sh.B.A.), ose USVisaAlbania (në Skype) për të folur me një operator që t'ju ndihmojë. Lutemi të ruani detajet e llogarisë suaj pasi juve mund t'ju duhet të hyni përsëri në këtë faqe interneti që të mësoni rreth statusit të dorëzimit të pasaportës suaj dhe/ose për të dërguar dokumente shtesë, nëse kërkohet nga Zyrtari Konsullor gjatë intervistës. Shërbimi postar falas i DHS-së është i vlefshëm vetëm brenda Shqipërisë.

- Printoni **fletën e konfirmimit të regjistrimit në shërbimin DHL** dhe silleni ditën e intervistës. Nëse ne nuk e marrim këtë informacion nga ju, do të krijohet vonesë në rastin tuaj të vizës emigruese. Viza juaj nuk do të lëshohet pa bërë regjistrimin për DHL-në për secilin aplikant.

15. PROVA TË LIDHJES SUAJ me të bashkëshortin/en qytetar amerikan (për peticionet CR-1, F2A dhe IR-1). Fakte dhe prova që tregojnë lidhjen tuaj me peticionerin, si p.sh. fotografi, korrespondencë, e-maile, ose prova të tjera që tregojnë lidhjen tuaj përgjatë kohës. Prova që tregojnë që peticioneri ka vizituar Shqipërinë, si p.sh. biletat e avionit apo edhe rezervimet.

16. PETICIONERI I Kategorisë së Vizës IR5 (Qytetar i SHBA-së që ka bërë peticion për prindin) mund të shoqërojë prindin në ditën e intervistës. Peticionerët e kategorive të tjera nuk janë të lejuar.

17. PROVA TË MBËSHTETJES FINANCIARE: **Për Peticionerin:**

a) Certifikatë lindjeje e peticionerit (qytetarit amerikan), e cila të jetë lëshuar jo më parë se një vit nga data e intervistës.
b) Formulari I-864 (Affidavit of Support) - Një garanci financiare origjinale (jo fotokopje, as me email) për secilin peticion. Pavarësisht nëse kualifikoheni për të sponsorizuar ose jo, ju si peticioner duhet patjetër që të dorëzoni formularin I-864. Ky dokument nuk duhet të jetë më i vjetër se 12 muaj kur të paraqitet në ditën e intervistës.
c) Fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit, të certifikatës së natyralizimit, ose të kartës së rezidentit të përhershëm të ligjshëm,

d) Vërtetim punësimi të lëshuar kohët e fundit, i cili të përmbajë informacion se për sa kohë keni qenë të punësuar dhe rrogën tuaj,
e) Taksat e vitit të fundit (Formulari 1040), ose një transkript apo kopje të taksave të marrë direkt nga Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave (IRS),
f) Formularët W-2 të vitit të fundit për të gjitha punët,
g) Nëse ju jeni i martuar, bashkëshortja juaj duhet **gjithashtu** të plotësojë dhe dorëzojë formularin I-864**A** (vini re: formulari I-864A është i ndryshëm nga I-864). Për më shumë informacion vizitoni faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "Udhëzimet e Dëshmisë së Mbështetjes". Formulari I-864 dhe I-864A gjenden në adresën e Internetit të Shërbimeve Amerikane të Qytetarisë dhe Emigracionit (USCIS) "Formularët" (në Anglisht).
h) Nëse ju (peticioneri) nuk keni deklaruar taksat vitin e kaluar, **ju duhet të përgatisni një deklaratë të nënshkruar ku shpjegoni arsyet përse nuk ju është kërkuar të deklaroni taksat** (p.sh. nëse ishit student, etj).

Sponsori Tjetër (Joint Sponsor):

i) Nëse të ardhurat tuaja (të peticionerit) janë nën 125 përqind të nivelit të varfërisë (poverty guideline), që vendoset çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shërbimeve të Shëndetit dhe Njeriut, apo nëse ju nuk jeni i kualifikueshëm për të sponsorizuar financiarisht të afërmin tuaj, ju duhet të siguroni një sponsor tjetër (joint sponsor), që të dorëzojë një Formular I-864, **si shtesë e Garancisë suaj Financiare I-864.** Ky formular I-864 duhet të jetë i firmosur origjinal (jo fotokopje, as me email) shoqëruar me fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit tjetër apo të kartës së tij të rezidentit të përhershëm të ligjshëm, taksat e vitit të fundit (Formulari 1040), formularët W-2 të vitit të fundit për të gjitha punët dhe vërtetim punësimi të lëshuar kohët e fundit. Pavarësisht sponsorit tjetër, ju si peticioner duhet patjetër që të dorëzoni formularin I-864.
j) Nëse sponsori tjetër është i martuar, bashkëshortja e tij duhet **gjithashtu** të plotësojë dhe dorëzojë formularin I-864A, në origjinal. Për më tepër informacion rreth dokumentacionit të kërkuar nga sponsori tjetër, ju lutemi vizitoni faqen e Internetit të Departamentit Amerikan të Shtetit, Byrosë së Çështjeve Konsullore "Lista për Përgatitjen e Formularëve të Dëshmive të Mbështjetjes".

Procesimi i Vizave Emigruese

Pas marrjes së aplikimit për vizë emigruese (peticionit), ai do të rishikohet nga NVC. Nëse dokumentacioni është i plotë, NVC-ja do të caktojë një datë takimi dhe do të njoftojë peticionerin apo aplikantin nëpërmjet një letre me datën e takimit për intervistë. Letra e datës së intervistës mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit, postës, apo shërbimit UPS.

Vini Re: Data tuaj e intervistës nuk caktohet nga Seksioni Konsullor, por nga NVC, me përjashtim të rasteve të rralla. Lexoni me kujdes letrën ose e-mailin që NVC i ka dërguar ju, peticionerit, ose agjentit tuaj, në lidhje me datën e intervistës dhe vizitën mjekësore.

Para Intervistës

1. APLIKANTI PËR VIZË i këtyre kategorive CR1, F2a dhe IR1 duhet të lexojë Informacionin për të Drejtat Ligjore në dispozicion të Imigrantëve Viktima të Dhunës Familjare (PDF 137.20 KB) në Shtetet e Bashkuara dhe Fakte rreth Imigrimit bazuar në Vizën e Martesës. Nëse ju nuk e lexoni këtë informacion, rasti juaj mund të vonohet për lëshimin e vizës.

2. VIZITA MJEKËSORE: Përpara intervistës për vizë, të gjithë aplikantët duhet t'i nënshtrohen vizitës mjekësore, e cila kryhet vetëm nga doktorët e autorizuar nga Seksioni Konsullor i Ambasadës Amerikane, në Tiranë.

Aplikanti duhet të paraqitet për vizitën mjekësore **fiks tre javë përpara datës** së intervistës. në rast se ju e morët njoftimin për datën e takimit më vonë se tre javë, ju ose dueht të kontaktoni brenda orarit zyrtar stafin mjekësor, ose të paraqiteni tek njëra nga adresat e mjekëve së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Ju duhet të shkarkoni e të lexoni me kujdes listën e Udhëzimeve Mjekësore, ta plotësoni atë dhe t'ia paraqisni doktorit të autorizuar. Aplikanti është gjithashtu përgjegjës për pagesën e tarifës së ekzaminimit nga mjekët.

Një ekzaminim mjekësor kërkohet edhe për çdo fëmijë shoqërues. Ju duhet të keni me vete fletën e datës së takimit në ditën e vizitës mjekësore.

Mos e dërgoni ekzaminimin mjekësor në Seksionin Konsullor përpara intervistës, përveç rasteve kur ju është komunikuar ndryshe. Ju duhet ta sillni zarfin e pahapur të ekzaminimit mjekësor në Seksionin Konsullor ditën e intervistës. **Mos e sillni grafinë e Rrezeve X në Seksionin Konsullor**. Lexoni më poshtë nën Paragrafin " Pasi të Keni Marrë Pasaportën dhe Paketën e Vizës" të këtij udhëzimi në lidhje me CD-në e rrezeve X.

Formularin e Vizitës Mjekësore mund ta gjeni në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "Përgatitja për Intervistë – Vizita Mjekësore". Kërkoni për TIA – Tirana dhe ju do të shkarkoni formularin e vizitës mjekësore.

Çfarë duhet të sillni me vete ditën e intervistës:

- Letrën e datës së takimit që keni marrë nga NVC;
- Zarfin e Vizitës Mjekësore të pahapur;
- Fotografi të re, të nxjerrë brenda 6 muajve të fundit;
- Dokumentet civile të lëshuara më parë se një vit konsiderohen si të skaduara. Nëse dokumentet janë lëshuar më shumë se një vit më parë, sillni dokumente civile të lëshuara kohët e fundit dhe/ose prova financiare si p.sh.: deklarimin e taksave të cilat mund të kenë ndryshuar që nga koha kur ju i keni dërguar ato fillimisht në NVC për shqyrtim.
- Nëse një sponsor ka dorëzuar formularin I-864, Garancia Financiare, DHE ka dërguar pranë NVC-së evidencë të Kërkesës për Shtyrjen e Afatit të Deklarimit të të Ardhurave (IRS Federal Income Tax Extension) në vend të Taksave të të Ardhurave Federale, aplikanti duhet të sjellë taksat federale të vitit më të fundit në ditën e intervistës.
- Fletën e regjistrimit për DHL.

Intervista

TARIFA E APLIKIMIT: Lutemi ndiqni udhëzimet në faqen e Internetit (në Anglisht) të Departamentit Amerikan të Shtetit Byrosë së Çështjeve Konsullore "Tarifat për Shërbimet e Vizave". Nëse peticioneri e ka kryer pagesën nëpërmjet NVC-së për ju, atëherë ju nuk do të keni nevojë të paguani në Seksionin Konsullor. Nëse jo, juve do t'ju kërkohet të kryeni pagesën ditën e intervistës. Kjo pagesë kryhet **vetëm** tek arkëtari i Seksionit Konsullor të Ambasadës Amerikane në Tiranë, vetëm me para në dorë në Dollarë ose Lekë.

Datat e takimit për intervistë caktohen nga NVC-ja dhe njoftimi për datën e intervistës ju vjen nga NVC-ja. Vetëm në raste të rralla data e takimit mund të caktohet nga Seksioni Konsullor i Ambasadës Amerikane në Tiranë.

Ju mund të shikoni statusin e rastit të vizës tuaj (në Anglisht) në: https://ceac.state.gov/CEAC/. Çfarë ju duhet juve është numri i rastit tuaj dhe vendi ku është kryer intervista (p.sh. Tiranë), për të monitoruar progresin e rastit tuaj.

Pas Intervistës

Pas intervistës suaj me Oficerin Konsullor, nëse dosja juaj është e plotë dhe ju të gjendeni të kualifikuar, viza juaj do të lëshohet dhe do t'ju dërgohet së bashku me paketën e vizës me anë të shërbimit postar DHL në zyrën që ju keni zgjedhur kur u regjistruat për këtë shërbim. Ju do të njoftoheni nga DHL-ja me anë të emailit për të tërhequr pasaportën dhe paketën e vizës suaj të emigrimit. E rëndësishme: Ju lutemi **mos e hapni zarfin e vulosur nga Ambasada** që ka paketën e vizës, përndryshe ai zarf bëhet i pavlefshëm.

Disa raste të aplikimeve për vizë mund të kërkojnë: a) dokumente shtesë ose b)proces të mëtejshëm administrativ.

c) Kur ju kërkohen dokumente shtesë, Oficeri Konsullor do ju japë një fletë refuzimi ku shpjegohen dokumentet e kërkuara. Pikat e shënuara me kryq aplikohen për rastin tuaj. Vini re që në atë letër Oficeri Konsullor, përveç gjuhës shqipe ku renditen dokumentet e kërkuara nga ju, mund të përdorë edhe gjuhën angleze për të shpjeguar dokumentet e kërkuara nga peticioneri apo sponsori nga SHBA. Ndaj, ju duhet t'ia dërgoni një kopje të letrës së refuzimit me faks apo email peticionerit në SHBA.

Këshillohet që t'i dërgoni të gjitha dokumentet e kërkuara njëherazi, pasi dërgimi i dokumenteve jo të plota do të vonojë rastin tuaj.

d) Procesi i mëtejshëm administrativ kërkon kohë shtesë pas intervistimit së aplikantit nga Oficeri Konsullor. Aplikantëve iu bëhet me dije kjo kërkesë ditën kur ata aplikojnë. Shumica e proceseve administrative zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e intervistës. Përpara se të kontaktojnë Zyrën Konsullore rreth statusit të procesit administrativ, aplikantët apo përfaqësuesit e tyre do të duhet të presin të paktën 60 ditë nga data e intervistës, apo nga data e dorëzimit të dokumenteve shtesë, në varësi se cila datë është më vonë. Nëse një proces administrativ është i nevojshëm, kohëzgjatja mund të ndryshojë sipas rrethanave individuale të çdo rasti.

Shumë e Rëndësishme

Asnjë lloj garancie nuk mund t'ju jepet paraprakisht lidhur me lëshimin e vizës. Vetëm Oficeri Konsullor mund të marrë një vendim pasi të ketë shqyrtuar të gjithë aplikimin tuaj zyrtar dhe t'ju ketë intervistuar ju personalisht.

Ju këshillojmë që të mos bëni përgatitje përfundimtare udhëtimi për t'u larguar nga vendi, të mos shisni pasurinë, dhe të mos lini punën derisa viza t'ju jetë lëshuar. Viza emigruese është në përgjithësi e vlefshme deri në gjashtë muaj nga dita e lëshimit të saj. Ju duhet të udhëtoni dhe të aplikoni për të hyrë në Shtetet e Bashkuara përpara se të skadojë viza.

Kjo zyrë do të bëjë çdo përpjekje që të përshpejtojë procesin. Gjithsesi, nëse do të jetë e nevojshme, aplikantëve mund t'u kërkohet të kthehen në Seksionin Konsullor edhe një herë, apo të dërgojnë informacion apo dokumentacion shtesë me postë.

Sipas nenit 203(g) të Aktit Amerikan të Emigracionit dhe Kombësisë (INA) kërkohet që emigranti i ardhshëm ta ndjekë aplikimin e tij për vizë brenda **një** viti nga data që është informuar për të bërë një gjë të tillë. Nëse ju nuk e ndiqni procesin brenda vitit, atëherë kërkesa juaj për vizë, si dhe çdo lloj peticioni lidhur me vizën, anullohet.